



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

II.EK.nr.316/20.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Lekë Prenaj, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të propozuesit Federata Sindikale e Pavarur e PTK-së, me seli në Prishtinë, lagja Dardania, pa numër, të cilën sipas autorizimit e përfaqësojnë Getoar Mjeku dhe Blerim Sallahu, kundër kundërshtarit të sigurimit Dardafon.net L.L.C., me seli në Fushë Kosovë, fshati Miradi e Epërme, rruga “Dëshmori”, pa numër, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Virtyt Ibrahimaga, avokat në Prishtinë, rruga “ Fehmi Agani ”, numër 1/16, duke vendosur lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurimit, pas mbajtjes së seancës dëgjimore, në të cilën prezentë ishin, përfaqësuesit e propozuesit, si dhe i autorizuari i kundërshtarit të sigurimit, më datë **10.08.2020**, mori këtë:

AKTVENDIM

I. REFUZOHET NË TËRËSI I PABAZUAR propozimi për caktimin e masës së sigurisë i propozuesit Federata Sindikale e Pavarur e PTK-së, me seli në Prishtinë, me të cilin ka kërkuar që të caktohet masa e sigurimit, ashtu që t'i:

II. Ndalohet kundërshtarit të sigurimit që:

(A) Të vazhdojë marrëveshjen e mbështetjes se operatorit të rrjetit mobil virtual, e lidhur me ndërmarrjen publike Telekom i Kosovës, SH.A., me 16 Janar 2009 dhe e përfunduar me 30 Korrik 2019;

(B) Të negociojë për të lidhur kontratë tjetër për rrjet virtual të telefonisë mobile;

(C) Të zbatojë çfarëdo kontrate që mund të kenë lidhur gjatë kohës mes përpilimit të kërkesës së paditëses-propozueses dhe shqyrtimit të saj.

III. T'i ndalohet të paditurit-kundërshtarit të sigurimit DARDAFON.net L.L.C., të tjetërsojë, të fshehtë, të ngarkojë ose të disponojë me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme me vlerë deri në 264.000.000,00 €.

IV. T'i ndalohet të paditurit-kundërshtarit të sigurimit DARDAFON.net L.L.C., që në cilësinë e kreditorit të kërkojë ose të pranojë nga Ndërmarrja Publike Telekomit i Kosovës SH.A., ose nga aksionari i saj:

(A) Përmbushjen e detyrimeve nga vendimi final i Arbitrazhit i datës 09 Dhjetor 2016, nxjerrë për rastin 2099/MHM, pranë Tribunalit të Odës Ekonomike Ndërkombëtare (ICC) dhe

(B) Përmbushjen e detyrimeve të tjera që mund të caktohen sipas Marrëveshjes së mbështetjes së operatorit të rrjetit mobil virtual, lidhur me ndërmarrjen publike Telekomit i Kosovës SH.A., me 16 Janar 2009.

IV. Të detyrohet i padituri-kundërshtari i sigurimit që të pezullojë të gjitha veprimet që kanë nisur në kundërshtim me këtë aktvendim.

A r s y e t i m

Pranë kësaj gjykate propozuesi Federata Sindikale e Pavarur e PTK-së, me seli në Prishtinë, ka parashtruar padi me propozim për caktimin e masës së sigurimit me datë 17.07.2020, më të cilën ka kërkuar nga gjykata që të caktojë masën e sigurisë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata duke vepruar sipas propozimit për caktimin e masës së sigurisë ka caktuar seancën dëgjimore për caktimin e masës së sigurisë me datë 10.08.2020, e cila fillimisht është paraqitur si kërkesë për caktim të masës së përkohshme të sigurimit, mirëpo pas vlerësimit të saj, gjykata e ka trajtuar si masë të rregulltë të sigurimit.

I autorizuari i propozuesit, Getoar Mjeku, në seancën dëgjimore ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë propozimit për caktimin e masës së sigurimit¹, duke theksuar së në këtë procedurë përfaqëson organizatën e gati 3500 punëtorëve, të cilët nuk kanë marrë pagat për shkak të gjendjes financiare të Telekomit. Ka shtuar së janë përmbushur kushtet nga neni 297 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK), për caktimin e masës së sigurimit, pasi që padia është e besueshme, si dhe është dëshmuar edhe rreziku i dëmit të riparueshëm, siç janë: 1. Dëmi i ri që shkaktohet nga kërkesat e palës kundërshtare, 2. Rreziku i tjetërsimit të pasurive të palës kundërshtare dhe 3. Rreziku i falimentimit të Telekomit të Kosovës, çka e cenon edhe sigurinë shtetërore. Ka theksuar se Telekomit i

¹ Propozimi për caktimin e masës së sigurimit, i datës 17.07.2020.

Kosovës është i vetmi operator i telekomunikimeve në vend që ofron shërbime të caktuara të domosdoshme për institucionet e shtetit, ndër këto institucione përfshihen AKI, Forca e Sigurisë, Policia, Qeveria, Shërbimet e Emergjencave, Institucionet Shëndetësore, Institucionet Arsimore, Gjykatat dhe Prokuroria. Me veprimtaritë e Telekomit, lidhet ngushtë edhe qëndrueshmëria e Postës së Kosovës dhe shërbimeve të saj, ndërsa punëtorët janë drejtpërdrejtë të rrezikuar nga gjendja e rënduar financiare meqë nuk po arrijnë të marrin pagat 80% të punëtorëve të Telekomit, të cilët kanë detyrime ndaj kredive që i kanë marrë, e gjithashtu gjendja e rënduar e Telekomit të Kosovës u pamundëson anëtarëve të sindikatës që të zhvillohen profesionalisht dhe të japin kontributin e tyre në një industri të avancuar të telekomunikacionit. Ka shtuar se si palë në këtë procedurë është thirrur në nenin 95 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje LMD), që në lidhje me nenin 89 dhe 90 të LMD-së, kanë kërkuar vërtetimin e nulitetit të kontratës. Sipas nenit 90 të LMD-së, pasojë e vërtetimit të nulitetit të kontratës është detyrimi i palës kontraktuese për të kthyer sendin e marrë, rrjedhimisht masat e sigurisë, andaj kanë kërkuar edhe për të mundësuar realizimin e kërkesëpadisë dhe të drejtave si të Sindikatës ashtu edhe të ndërmarrjes ku punojnë anëtarët e Sindikatës, në përputhje me nenin 90 të LMD-së. I autorizuari i propozueses, ka shtuar se Sindikata nuk është palë e marrëveshjes së arbitrazhit por e drejta e saj për padi mbështetet në nenin 95 të LMD-së, ku e drejta për këtë padi nuk parshkruhet sipas nenit 96, sindikata nuk paragjykon të drejtat e palëve të tjera por kërkon parandalimin e dëmit dhe ruajtjen e rrethanave dhe mjeteve për të realizuar kërkesëpadinë. Kjo gjykatë nuk është e lidhur me procedurat e tjera që mund të zhvillohen por mund të caktojë masa edhe në përputhje me rregullat e përmbartimit gjyqësor sipas nenit 307 LPK-së. Objekt shqyrtimi i përmbajtjes së kontratës është nuliteti i saj e jo detyrimet ose të drejtat si në procedurat e tjera. Masa e sigurimit nuk paragjykon as mohon të drejtat e palëve.

I autorizuari i kundërshtarit të sigurimit av. Virtyt Ibrahimaga, në seancën dëgjimore ka deklaruar se mbetemi në tërësi pranë përgjigjes në propozimin për caktimin e masës së sigurimit, duke ritheksuar se edhe pse e ka trajtuar në përgjigje në padi, thekson se palët kontraktuese pra dy subjektet juridike të tjera nga propozuesja lidhur me kontestet që rrjedhin nga kontrata e tyre e kanë kontraktuar arbitrazhin ndërkombëtar ICC me seli në Londër, të cilën çështje pala kontraktuese nuk e ka kundërshtuar. Andaj, për këtë arsye kjo gjykatë nuk mund të ketë juridiksion mbi kërkesën mbi masë të sigurisë dhe kërkesa duhet të hedhet si e palejueshme. Sa i përket materies, ka shtuar se propozuesja ka bërë një varg kërkesash mirëpo ka dështuar që të dëshmojë bazueshmërinë e kërkesës së saj si dhe dëmin e menjëhershëm dhe të pa riparueshëm i cili ndërlidhet me kërkesën. Në pikën numër 2, propozuesja ka kërkuar që kontrata e datës 16.01.2009, e cila ka përfunduar me datë 30.07.2019, të mos vazhdohet, andaj propozuesja nuk ka paraqitur asnjë dëshmi që kjo kontratë vazhdohet ose është në procedurë të negocimit, por edhe sikur të ishte, vetë propozuesja thekson se do të duhej një kontratë e re, ç'është e vërteta nga data 31.07.2019, kontrata e cila është objekt i padisë është shkëputur nga ana e Telekomit të Kosovës dhe ajo kontratë nuk ekziston më, prandaj kërkesa e propozueses nuk është e bazuar me ligj dhe

duhet të refuzohet si e tillë. Në pikën numër 3, propozuesja ka kërkuar që gjykata t'ia ndaloj palës kundërpropozuese të disponojë me pasurinë saj në vlerë prej 264.000.000,00 €, është plotësisht e pa bazuar kjo kërkesë meqenëse nuk është elaboruar se mbi çfarë baze propozuesja ka ardhur deri te kjo vlerë dhe pse kjo vlerë duhet të ndalohet kundërpropozueses që të vejë në qarkullim, duhet theksuar se kundërpropozuesja këtë vlerë nuk e ka dhe nuk e ka të qartë se për çfarë arsye është bërë kjo kërkesë mbi të cilën ajo bazohet. Sa i përket kërkesës numër 4, propozuesja kërkon nga gjykata që të ndalojë ekzekutimin e një vendimi të formës së prerë të një gjykate tjetër. Duhet theksuar se vendimi final i arbitrazhit i datës 09.12.2016 me numër 20990/MHM është i plotfuqishëm dhe ai vendim është njohur nga Departamenti i njejtë i kësaj gjykate përmes aktvendimit të datës 31.01.2019, i cili vendim është i formës së prerë dhe i gjykuar, andaj kjo gjykatë nuk mund të ndalë ekzekutimin e këtij vendimi. Duhet theksuar se ky vendim është shpallur i pambarueshëm nga ana e Gjykatës Themelore-Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.1486/2019, kundër të cilit Telekom i Kosovës ka ushtruar ankesë dhe njëkohësisht ka kërkuar që të shtyhet përmbarimi i këtij vendimi, pra kjo çështje është në shqyrtim nga Gjykata e Apelit në çështjen përmbarimore pra çështja e përmbarimit të këtij vendimi, përderisa vendimi si i tillë, është shpallur si i njohur dhe i ekzekutueshëm në Kosovë.

Ka shtuar se propozuesja në asnjë moment nuk e ka dëshmuar se kjo kërkesë është e bazuar në ligj dhe se ndërlidhet me kërkesëpadinë dhe të drejtat e saj subjektive, e po ashtu padia nuk përmban asnjë dokument i cili dëshmon ose e bën të besueshëm që kërkesa nga kërkesëpadia mund të jetë e suksesshme, ky është parakushti i parë i cili duhet të merret parasysh me rastin e nxjerrjes së masës së sigurisë, elaborimi në kërkesë për masë të sigurisë është abstrakt dhe pa ndonjë referencë në ndonjë dokument ose elaborim juridik sa i përket besueshmërisë padisë, e gjithashtu nuk e ka bërë të besueshëm se asaj i rrezikohet një dëm i riparueshëm, mirëpo ajo është thirrur në interesa të palës së tretë, që në këtë rast është Telekom i Kosovës dhe kinse interesa kombëtare, por nuk ka elaboruar se cili dëm i shkaktohet asaj. Ka theksuar se propozuesja në seancën dëgjimore ka pretenduar se në rrezik janë pagat e punëtorëve, përveç faktit se nuk është dorëzuar asnjë dëshmi duhet marr parasysh se kërkesëpadia e saj nuk ka të bëjë asgjë me operimin ekonomik të Telekomit të Kosovës. Për fund ka theksuar se Telekom i Kosovës është shoqëri aksionare në pronësi të Republikës së Kosovës, e që në parim mungesa e mjeteve për të operuar nuk është arsye për masë të sigurisë ndaj pasurisë së tjetrit, andaj Telekom i Kosovës operon dhe ka mundësi që në rast të mungesës së likuiditetit të ketë qasje në financim por edhe aksionari i saj mund të rris kapitalin, e që një palë nuk ka mundësi që në procedurë të kërkojë ndalimin e ekzekutimit të një vendimi i cili është në kompetencë të ekzekutimit nga gjykata tjetër në procedurë të përmbarimit, përndryshe gjykata do të ndërhynte në kompetencë të gjykatës tjetër.

I ka propozuar gjykatës që ta refuzojë propozimin për caktimin e masës së sigurimit, ndërkaq në rast se gjykata do ta caktoj masën e sigurimit, atëherë ta refuzojë kërkesën për ndalimin e ekzekutimit të përmbarimit të vendimit për përmbarim.

Lidhur me propozimin për sigurimin e kërkesëpadisë gjykata ka administruar provat dhe atë: Vendimin nr.1455 për caktimin e numeracionit jo gjeografik (mobil) nga seritë 045 5 xxx, 045 6 xxx, 046 1 xxx, për përdorim nga Operatori Telekom i Kosovës SH.A. i datës 15.10.2019; CD-në me 44 shtojca pjesë e shkresave të lëndës, administrimi i të cilave nuk ishte kontestues për palët (sa i përket administrimit).

Duke e marrë në konsideratë llojin e masës së propozuar sipas gjykatës, fakteve të konstatuara gjër në këtë fazë të procedurës e në përputhje me dispozitat e LPK-së nga neni 297 par.1, 2 dhe 3 i LPK-së gjykata gjeti se propozimi është i pabazuar.

Pathemelësia e propozimit për sigurimin e kërkesëpadisë nuk është diktuar nga rrethana e legjitimitetit të palëve sepse gjykata e gjen të legjitimuar palën paditëse në kuptimin real aktiv për shkak të përmbajtjes së kërkesës për shkaqe të nulitetit absolut, por pathemelësia është diktuar nga mosplotësimi i kushteve kumulative për sigurimin e kërkesëpadisë.

Duke iu referuar dispozitave nga neni 297 i LPK-së, rezulton se për sigurimin e kërkesëpadisë duhet të plotësohen kushtet dhe atë : besueshmëria e kërkesës apo e të drejtës subjektive, ekzistimi i rrezikut se pa caktimin e masës do të pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës dhe caktimi-deponimi i garancionit për dëmin e mundshëm që mund të shkaktohet për shkak të sigurimit të kërkesës.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se propozimi për sigurimin e kërkesëpadisë është i pathemeltë për shkak se nuk plotësohet kushti i besueshmërisë së kërkesës respektivisht të drejtës subjektive.

Vlerësimi i këtij kushti nga ana e gjykatës është bërë në kontekstin e rrethanave të provuara të çështjes kontestuese nga rezulton se me sigurimin e kërkesëpadisë është kërkuar të pezullohet zbatimi i procedurës së përmbarimit sipas një dokumenti përmbarimor i cili i ka plotësuar të gjitha kushtet për lejimin dhe zbatimin e përmbarimit dhe që gjendet në fazën e zbatimit. Pjesa dërrmuese e pretendimeve të parashtruara në procedurën e sigurimit të kërkesëpadisë janë pretendime që janë shqyrtuar dhe konsumuar në procedurën e zhvilluar paraprakisht në mes palëve ndërgjyqësore lidhur me të drejtën e të paditurës-kundërshtares së sigurimit e konfirmuar me vendimin e arbitrazhit të dt. 09.12.2016, 2099/MHM pranë Tribunalit të Odës Ekonomike Ndërkombëtare ICC në Londër, i cili e ka kaluar edhe fazën e njohjes nga gjykata kompetente në Kosovë.

Përveç kësaj poashtu një pjesë e pretendimeve të parashtruara në procedurën e sigurimit të kërkesëpadisë janë pretendime të natyrës së tillë që janë parashtruar ose do të mund të parashtroheshin në procedurën e përmbarimit. Pra, debitori e ka mundësinë që në procedurën e përmbarimit të parashtrorë të gjitha pretendimet për shkaqet që përbëjnë bazë legale për refuzimin e propozimit për lejim të përmbarimit apo edhe për pezullim të procedurës pas lejimit të përmbarimit, mirëpo siç mund të kuptohet nga shkresat e lëndës

edhe ajo fazë e procedurës në të cilën vlerësohen pretendimet e debitorit tanimë është e konsumuar.

Refuzimi i propozimit të sigurimit të kërkesëpadsisë në rastin konkret është në përputhje edhe me standardin e sigurisë juridike sepse gjykates nga kjo procedurë nuk i lejohet që të bëjë vlerësime të dyfishta për aktin i cili shërben si dokument përmbartimor mbi bazën e të cilit është lejuar dhe zbatuar përmbartimi.

Përveç të lartëcekurave gjykata vlerëson se refuzimi i propozimit për sigurim të kërkesëpadsisë është në përputhje edhe me nenin 300 par.3 i LPK-së, për shkak se nëse gjykata do ta pranonte propozimin për sigurimin e kërkesëpadsisë përveç se do të përfshinte pjesërisht objektin e kontestit do të paragjykonte tërësisht përfundimin e çështjes meritore për shkak se vlerësimi i besueshmërisë së kërkesës veçanërisht në raport me çështjen kontraktuese të palëve ndërgjyqëse do të bëhej specifikisht mbi rrethana të cilat potencialisht mund të përbënin edhe shkaqe për anulimin e kontratës.

Meqenëse pala paditëse nuk e ka bërë të besueshme kërkesën e as të drejtën e saj subjektive, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston rreziku që pala kundërshtarë do t'a pamundësonte ose vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës së palës propozuese.

Andaj, gjykata përfundimisht vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet e përcaktuara me nenin 297 paragrafi 1 pika a) dhe b) të LPK-së, ku të njëjtat kushte duhet të përmbushen në mënyrë kumulative, që të mund të caktohet masa e sigurimit sikurse është kërkuar, andaj në këtë rast gjykata vlerëson së tani për tani kërkesa e propozueses është e pabazuar, ndërsa vendosja sikurse në dispozitiv asesi nuk prejudikon vendosjen në çështjen meritore sipas padsisë së paraqitur nga paditësja Federata Sindikale e Pavarur e PTK-së, me seli në Prishtinë.

Nga sa u tha më lartë e duke u bazuar ne dispozitën e nenit 297 paragrafi 1 pika a) dhe b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Çështje Ekonomike.
II.EK.nr.316/20, datë 10.08.2020.



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes se të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosoves, në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.